



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE  
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 3, Datë 29.06.2015

PËR

MIRATIMIN E LEJES SË NDËRTIMIT PËR PROJEKTIN “NDËRTIMI I  
HIDROCENTRALIT DENAS”, ME VENDNDODHJE NË PELLGUN UJËMBLEDHËS TË  
RRJEDHËS SË POSHTME TË LUMIT TË ÇEMERICËS, ISH-KOMUNA LEKAS, QARKU  
KORÇË”

Në mbështetje të neneve 27 dhe 28 të Ligjit nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, nenit 19 të Vendimit nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit” dhe Vendimit nr. 877, datë 03.10.2013 të Këshillit të Ministrave “Për përbërjen e Këshillit Kombëtar të Territorit”, me propozimin e Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Miratimin e Lejes së Ndërtimit për projektin “Ndërtimi i Hidrocentralit Denas”, me vendndodhje në pellgun ujëmbledhës të rrjedhës së poshtme të lumit të Çemicës, Ish-Komuna Lekas, Qarku Korçë”, me subjekt kërkues shoqërinë konçesionare “Denas Power” sh.p.k.
2. Pjesë përbërëse të këtij vendimi janë:
  - a. Dokumenti i Rregullores së Lejes së Ndërtimit;
  - b. Harta e Planvendosjes së Strukturës së Hidrocentralit “Denas”.
3. Ngarkohet Ministria e Energjisë dhe Industrisë për lëshimin e Formularit të Lejes së Ndërtimit.
4. Formulari i Lejes së Ndërtimit i jepet subjektit kërkues vetëm pas pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë, për llogari të Njesisë së Qeverisjes Vendore.
5. Ngarkohet Ministria e Energjisë dhe Industrisë dhe Njësia e Qeverisjes Vendore për zbatimin e këtij vendimi.
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

EDI RAMA



**ZËVENDËS KRYETARE E KKT**

**EGLANTINA GJERMENI**

MINISTËR I ZHVILLIMIT URBAN



**Z. DAMIAN GJIKNURI**

MINISTËR I ENERGISË DHE INDUSTRIË

**SEKRETARE E KKT**

**ADELINA GRECA**

A handwritten signature in blue ink, appearing to read "Adelina Greca", written over a horizontal line.



DREJTORE E AGJENCISË KOMBËTARE TË PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT